



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit dhe Shkencës/ Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education
and Science*

*Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretara/Office of the General
Secretary*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS-MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE-MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE	
Njësia org. <u>2</u>	DALJE
Nr. Prot./Br./No. <u>3691</u>	Data/Datum/Date <u>27.07.26</u>
Nr. i faq./Br./sz/No.pg. <u>3</u>	
Prishtinë / Priština / Pristina	

Nr. 2/3691
Dt. 27/07/2026

Sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta zyrtare nr. 7 / 01 mars 2019), nenit 45 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore, nxjerr:

V E N D I M

Për miratimin e listës së përzgjedhur nga Këshilli Shkencor i MASH për përfituesit e projekteve të vogla shkencore për vitin 2026

1. Miratohet lista e përzgjedhur e Këshillit Shkencor të MASH-it për përfituesit e projekteve të vogla shkencore 2026, të aprovuara për financim, si në vijim:

1.1. Projekti me titull "Optimizimi i kulturës In Vitro të kallusit të rrushit Vranac (Vitis vinifera L.) si burim i qëndrueshëm i komponimeve bioaktive për ruajtjen e ushqimit" me bartëse prof. Dafina Llugaçiu-Krasniqi nga Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë, Fakulteti i Teknologjisë ushqimore, aprovohet nga Këshilli Shkencor i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 8,500.00euro.

1.2. Projekti me titull "Cikli i lëvozhgave të vezëve: Transformimi i lëvozhgës së vezës në zingjirin e vlerës qarkulluese" me bartëse prof. Alltane Kryeziu nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, aprovohet nga Këshilli Shkencor i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në vlerë 7,980.00 euro.

1.3. Projekti me titull "An Agent-Based Robot Orchestration Framework at the Edge", me bartës prof. Ilir Murturi nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, aprovohet nga Këshilli Shkencor i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në vlerë 9,000.00 euro.

1.4. Projekti me titull "Inteligjenca artificiale për shërbime digjitale dhe menaxhim të të dhënave në arsimin e lartë" me bartës prof. Eliot Bytyqi nga Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, aprovohet nga Këshilli Shkencor i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 7,800.00 euro.

1.5. Projekti me titull "Kosova në luftën e ftohtë 1945-1989: Politika e jashtme amerikane- Dokumente arkivore të Shqetëve të Bashkuara të Amerikës" me bartës z. Arbër Hadri nga Instituti i Historisë "Ali Hadri", aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 6,500.00 euro.

1.6. Projekti me titull "Historia, kultura dhe qytetaria në arsimin parauniversitar" me bartës prof. Et'hem Çeku nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 5,300.00 euro.

1.7. Projekti me titull "Matrica digjitale e mendimit sociologjik në Kosovë" me bartëse prof. Linda Gusia nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 9,000.00 euro.

1.8. Projekti me titull "Zgjidhjet energjetike në ndërtesa me Zero Emetime", me bartës prof. Bedri Dragusha nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 7,550.00 euro.

1.9. Projekti me titull "Tretësit eutektike të thellë për teknologji të gjelbra: lidhja ndërmjet strukturës, vetive termofizike dhe aplikimeve", me bartës prof. Fisnik Aliaj nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 9,000.00 euro.

1.10. Projekti me titull "Depozitimi atmosferik i metaleve të rënda dhe mikroplastikave në qytetin e Prishtinës përmes myshqeve dhe liqeneve të transplantuara si bioindikatore" me bartës prof. Musaj Paqarizi, Universiteti Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 9,000.00 euro.

1.11. Projekti me titull "Zhvillimi i metodave FTIR-PLSR për kontrollin e autenticitetit të vajit të ullirit dhe vajrave vegjetale" me bartës prof. Fatos Rexhepi nga Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë, Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 8,500.00 euro.

1.12. Projekti me titull "Përshatjet metabolomike dhe rregullimi nga mikroARN-të në përgjigje ndaj stresëve mjedisore tek bimët ballkanike të ringjalljes" me bartës prof. Bekim Gashi nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 8,000.00 euro.

1.13. Projekti me titull “Bargrafet me ngjyra”, me bartës prof. Armend Shabani nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Matematiko- Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 7,500.00 euro.

1.14. Projekti me titull “Studimi i diversitetit, taksonomisë dhe përhapjes së fiernave (Pteridophyta) në Republikën e Kosovës”, me bartës prof. Elez Krasniqi nga Universiteti Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 9,000.00 euro.

1.15. Projekti me titull “Edukimi mjedisor dhe vetëdijesimi ekologjik në Kosovë” me bartës prof. Rifat Morina nga Universiteti “Ukshin Hoti “ në Prizren, Fakulteti i Edukimit, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 8,500.00 euro.

1.16. Projekti me titull “Përqendrimi i metaleve të rënda në materien grimcore, $PM_{2.5}$ & PM_{10} $\mu g/m^3$ dhe hirin fluturues në zonat industriale të Kosovës: Vlerësim sipas standardeve të BE-së” me bartës prof. Skënder Demaku nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, aprovohet nga KSH i MASH dhe rekomandohet për financim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vlerë 9,000.00 euro.

2.Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë, kërkesën e DALSH/MASH nr.5/1367 dt. 20.07.2026 për miratimin e listës së përzgjedhur nga Këshilli Shkencor i MASHTI për përfituesit e projekteve të vogla shkencore për vitin 2026, procesverbalin e mbledhjes së Këshillit Shkencor të MASH të datës 16.07.2026, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Të lartpërmendurve;
2. Zyrës së Sekretares së përgjithshme/MASH;
3. DALSH/MASH;
4. Arkivit të MASH.

Fadile Dyla

Sekretare e përgjithshme/MASH

